

# RAPORT

## PËR ZGJIDHJET E MUNDSHME PËR SIGURIMIN E PAVARËSISË DHE QËNDUESHMËRISË TË AGJENCISË INFORMATIVE MEDIATIKE (MIA)

Sandra Bashiq Hrvatin dhe Snezhana Trpevska

# RAPORT

për zgjidhjet e mundshme për sigurimin e pavarësisë dhe qëndrueshmërisë të  
Agjencisë Informative Mediatike (MIA)

**Autore:**

**Sandra Bashiq Hrvatin**

**Snezhana Trpevska**

**Shkup/ Ljublanë, korrik 2023**

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

## **I. VLERËSIM** i statusit ligjor ekzistues, menaxhimit dhe financimit të Agjencisë Informative Mediatike (MIA)

### **Snezhana Trpevska**

#### 1. Hyrje

Ky vlerësim është një dokument fillestar, qëllimi i të cilit është të përshkruajë statusin aktual ligjor të Agjencisë Informative Mediatike (MIA) dhe të identifikojë mangësitë dhe sfidat e modelit ligjor sa i përket autonomisë së saj institucionale dhe pavarësisë editoriale. Gjetjet e vlerësimit duhet të shërbejnë për të përcaktuar kahjet e mundshme të transformimit ligjor të MIA-it në një shërbim të pavarur dhe autonom të informimit publik.

Vlerësimi është bërë në kuadër të projektit “Promovimi i sigurisë së gazetarëve, standardeve profesionale dhe qëndrueshmërisë së mediave” që e zbaton Misioni i OSBE-së në Shkup.

## 2. Aktet ligjore që rregullojnë punën e MIA-it

### 2.1. Akti i parë – Vendimi i Kuvendit i vitit 1992

Akti i parë me të cilin u rregullua themelimi dhe funksionimi i MIA-it (atëherë me emër: Agjencia Informative e Maqedonisë), pas pavarësisë, është Vendimi i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë i miratuar më 18 shkurt të vitit 1992<sup>1</sup>.

Sipas këtij akti, statusi dhe funksionimi i MIA-it rregullohej si vijon:

- *Statusi juridik dhe veprimtaria:* themelohet si ndërmarrje publike, qëllimi kryesor i së cilës është të ofrojë “informim të plotë, në kohë dhe objektiv për qytetarët, si dhe informimin e publikut ndërkombëtar për aktivitetet e autoriteteve shtetërore dhe subjekteve të tjera të Republikës”.

---

<sup>1</sup> Gazeta zyrtare e RM-së nr. 10/92 e 26 Shkurtit të vitit 1992, fq. 112. Në dispozicion:  
<https://www.slvesnik.com.mk/Issues/A93D0D03476F4CE0867C35C941E417C6.pdf>

- *Organet drejtuese:* Organi kryesor drejtues, sipas nenit 6 të Vendimit, ishte Këshilli i përbërë nga 9 anëtarë, 6 prej të cilëve i emëron Kuvendi dhe 3 zgjidhen nga radhët e të punësuarve. Këshilli miraton Statutin (për të cilin Kuvendi jep pëlqimin), i propozon Kuvendit plane afatmesme dhe afatgjata, emëron dhe shkarkon drejtorin dhe kryeredaktorin, përcakton çmimet e shërbimeve të ofruara nga MIA-i dhe kryen detyra të tjera. Drejtori dhe kryeredaktori zgjidhen nga Këshilli në bazë të konkursit, me pëlqimin e Kuvendit.
- *Mënyra e financimit:* mjetet për themelimin dhe funksionimin sigurohen nga Buxheti, kurse mjete shtesë (për kryerjen e aktivitetit dhe për zhvillim tekniko-teknologjik) mund të sigurohen edhe nga shitja e produkteve dhe shërbimeve në treg.

Shënim: Në praktikë ky vendim i Kuvendit nuk është zbatuar për shkak të mosmarrëveshjeve politike, pra aktivizimi dhe funksionimi i Agjencisë është shtyrë për 5-6 vitet e ardhshme. Në ndërkohë, me vendim të Qeverisë nga maji i vitit 1992, punën e agjencisë e kryente Byroja e Shtypit e Maqedonisë (BSHM), me qëllim për të kryer “punë dhe detyra informative dhe promovuese jashtë vendit<sup>2</sup>. Gjatë vitit 1997, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi konkluzion për zbatimin e Vendimit të Kuvendit, në atë mënyrë që ajo vetë t'i marrë të drejtat e themelimit të NP Agjencia Informative e Maqedonisë.<sup>3</sup> Më 1 dhjetor 1997 është marrë Vendimi<sup>4</sup> për anulimin

---

<sup>2</sup> Gazeta zyrtare e RM-së nr. 10/92 e 26 Shkurtit 1992, fq.112. Në dispozicion:

<https://www.slvesnik.com.mk/issues/A93D0D03476F4CE0867C35C941E417C6.pdf>

<sup>3</sup> Në arkivin e Gazetës zyrtare të RM-së që është i disponueshëm publikisht nuk mund të gjehet vendim i veçantë i Qeverisë për formimin e NP Agjencisë maqedonase të infomimit, të miratuar në vitin 1997.

<sup>4</sup> Gazeta zyrtare e RM-së nr. 62/97 e 9 Dhjetorit të vitit 1997, fq. 2723. Në dispozicion:

<https://www.slvesnik.com.mk/issues/55E997B75DBD4E8BB7A1358CF1C65EA5.pdf>

e vendimit për themelimin e Byrosë për Shtyp të Maqedonisë, ndërsa më 2 shkurt 1998 është marrë Vendim për miratimin e Statutit të NP Agjencia Informative e Maqedonisë <sup>5</sup>.

## 2.2. Vendimi i Qeverisë për transformimin e MIA-it nga viti 2006

Në prill të vitit 2006, me vendim të Qeverisë së RM-së<sup>6</sup>, ndërmarrja publike MIA është shndërruar në shoqëri aksionare në pronësi të shtetit, me emërtim zyrtar “Shoqëri aksionare Agjencia Informative e Maqedonisë SHA – Shkup. në pronësi shtetërore”, ose me emrin e shkurtuar SHA “MIA” – Shkup .

Në këtë Vendim, statusi dhe puna e SHA MIA rregullohet si në vijim:

- *Statusi juridik dhe veprimtaria:* themelohet (në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare) si shoqëri aksionare në pronësi të plotë shtetërore, qëllimi themelor i së cilës është i njëjtë me vendimin e Kuvendit të vitit 1992. të sigurojë: “informimin e plotë, në kohë dhe objektiv të qytetarëve, si dhe informimin e publikut ndërkombëtar për veprimtarinë e autoriteteve republikane dhe subjekteve të tjera në Republikë.” Shtohet një dispozitë për veprimtarinë bazike – veprimtarinë e agjencive të lajmeve. (kodi 92.40, sipas klasifikimit të veprimtarive).
- *Vazhdimësia juridike:* në nenin 7 konstatohet se kapitali themelor i SHA MIA janë mjetet, pajisjet dhe prona e NP të mëparshme e Agjencisë Informative të

---

<sup>5</sup> Gazeta zyrtare e RM-së nr. 62/97 e 9 Dhjetorit të vitit 1997, fq. 2723. Në dispozicion: <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/55E997B75DBD4E8BB7A1358CF1C65EA5.pdf>

<sup>6</sup> Gazeta zyrtare e RM-së nr. 7/1998 e 10 Shkurtit të vitit 1998, fq. 360. Në dispozicion: <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/850BBFECDDC6494D976CF4942F6D4E0F.pdf>

Maqedonisë, dhe në nenin 12 thuhet se kapitali, asetet dhe punëtorët, të drejtat dhe obligimet lidhur me funksionimin e NP *MIA* do t'i barten SHA *MIA* - Shkup.

- *Organet drejtuese*: Me *MIA*-in menaxhon Këshilli Mbikëqyrës dhe Këshilli Drejtues. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 5 anëtarë të cilët zgjidhen nga Qeveria e RM-së, në cilësinë e Mbledhjes së Aksionarëve (neni 10). Gjithashtu parashikohet se “një e katërta e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës janë anëtarë të pavarur”, por nuk specifikohen kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe nuk definohet as konflikti i interesit. Nuk janë të specifikuar kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës, përveç se ai i zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues. Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë. Kompetencat e tij nuk janë të specifikuar, përveç se ai drejton punën e kompanisë.

- *Mënyra e financimit*: nuk ka dispozita që rregullojnë mënyrën e financimit. *MIA*-i financohet nga Buxheti i RM-së, nga mjetet e ndara për Shërbimin për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, zëri 461 – subvencione për ndërmarrjet publike.

### 2.3. Statuti i SHA *MIA* nga viti 2006 dhe ndryshimet pasuese

Vendimi i Qeverisë i vitit 2006 përmban edhe një dispozitë që SHA *MIA* miraton Statut, por nuk thuhet qartë se cili autoritet e miraton Statutin. Megjithatë, sipas nenit 383, paragrafi 1 të Ligjit për Shoqëri Tregtare, këtë akt e miraton Qeveria e RMV-së. Të gjitha çështjet tjera të parregulluara me Vendim janë të rregulluara me këtë akt, i cili

është miratuar edhe në vitin 2006<sup>7</sup> dhe më pas është ndryshuar me vendimet e vitit 2007, 2013, 2014, 2015 dhe 2019<sup>8</sup>.

Me Statut gjendja juridike dhe funksionimi i SHA *MIA* rregullohet si vijon:

- *Gjendja juridike dhe veprimtaria*: Përsëritet dispozita nga Vendimi se *MIA*-i themelohet si shoqëri aksionare në pronësi të plotë shtetërore, e cila ushtron veprimtarinë – aktivitetet i agjencive të lajmeve (kodi 92.40, sipas klasifikimit të veprimtarive).
- *Kapitali themelor dhe vlera nominale e aksioneve*: Neni 8 i Statutit thotë se kapitali bazë i SHA *MIA* është 60.659,40 euro ose 3.730.600,00 denarë. Kapitali bazë është i ndarë në 60.659 aksione të zakonshme, me vlerë nominale 1 euro = 61,5 denarë për aksion. Në bazë të nenit 9, krijohet një fond nga i cili punonjësit mund të blejnë aksione falas ose me një çmim preferencial. Pjesa e aksioneve të punonjësve mund të jetë deri në një të dhjetën e kapitalit aksionar. Organizimi dhe menaxhimi i Fondit, si dhe mënyra e shpërndarjes së mjeteve të destinuara për aksione, rregullohen me akt të Kuvendit të SHA *MIA*, përkatësisht të Qeverisë.
- *Kuvendi i SH.A. MIA*: të drejtat dhe obligimet e Kuvendit të shoqërisë i kryen Qeveria e RSM-së. Kompetencat e Kuvendit rrjedhin nga neni 383 paragrafi 1 i Ligjit për shoqëri tregtare dhe ato janë të përsëritura në Statutin e *MIA*-it: vendos për ndryshimin e Statutit; miraton llogarinë përfundimtare, raportet

<sup>7</sup> Gazeta zyrtare e RM-së nr. 53/06 e 24 Prillit të vitit 2006. Në dispozicion:

<https://www.slvesnik.com.mk/Issues/F756271797DCA04F877384F2E223C61F.pdf>

<sup>8</sup> Taksti i azhuruar i Statutit është botuar në Gazetën zyrtare të RM-së nr. 125/19 të 19 Qershorit të vitit 2019. Në dispozicion: <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/c30adebc3a6048ffa8673fd45b8b64a6.pdf>



financiare dhe vjetore; vendos për shpërndarjen e fitimit; zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës; miraton Programin për blerjen e aksioneve nga punonjësit dhe Vendimin për kriteret e ndarjes; lëshon aksione të destinuara për fondin; jep pëlqimin për aktin për vlerën e pikëve për llogaritjen e pagave të punonjësve; dhe kompetenca të tjera.

- *Organet drejtuese*: përsëriten dispozitat e Vendimit se MIA drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Këshilli Drejtues, por rregullohen edhe çështje të tjera.
- Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga pesë (5) anëtarë me mandat katër vjeçar, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i shoqërisë, përkatësisht Qeveria e RM-së, në cilësinë e Kuvendit të Aksionarëve. Dy nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë anëtarë të pavarur”, por edhe Statuti nuk përcakton kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët dhe as konfliktin e interesit. Vetëm shtohet se “gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës theksohet se cilët anëtarë janë të pavarur.” Përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës janë: zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues, mbikëqyr punën, inspekton dhe kontrollon librat dhe dokumentet e Shoqërisë, si dhe pasurinë, veçanërisht arkën dhe letrat me vlerë të shoqërisë.
- Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë (5) anëtarë, me mandat katërvjeçar. Ata zgjidhen nga Këshilli Mbikëqyrës, me votim të hapur, por nuk specifikohen kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët dhe as konflikti i interesit. Në nenet 21 dhe 22 të STA-së tutit hollësisht janë paraparë përgjegjësitë e Këshillit Drejtues, duke përfshirë: miraton Programin e Punës dhe Zhvillimit, Planin Vjetor të Punës dhe Planin Vjetor Financiar, përgatit aktet dhe vendimet që i miraton Kuvendi, përgatit dhe dorëzon raportet financiare tremujore në

Këshillin Mbikëqyrës dhe Qeveri, në cilësinë e Kuvendit, emëron drejtuesit që udhëheqin punën e Shoqërisë, vendos për organizimin e brendshëm të Shoqërisë dhe një sërë kompetencash të tjera.

- Statuti përmban dispozita (neni 28) për kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm, por ky akt nuk rregullon mënyrën e zgjedhjes së tij, kriteret që duhet të plotësojë dhe konfliktin e interesit.
- Mënyra e financimit: në Statut, si dhe në Vendim, nuk ka dispozita që rregullojnë mënyrën e financimit. MIA-ja financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga mjetet e ndara për Shërbimin për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë së RM-së, zëri 461 – subvencione për ndërmarrjet publike.

### **3. Konkluzione nga vlerësimi dhe nga tryeza e rrumbullakët me përfaqësues të institucioneve të rëndësishme**

Për nevojat e këtij vlerësimi, në fazën e pare, janë analizuar dokumentet dhe artikujt e tjerë të publikuar për këtë temë, si dhe janë realizuar 4 intervista me ekspertë dhe përfaqësues të MIA-it dhe organizatave tjera.

Më 31 mars 2023, në Veles, Misioni i OSBE-së në Shkup organizoi tryezën e rrumbullakët me temën “Zgjidhjet për pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e Agjencisë Informative Mediatike (MIA)”<sup>9</sup>. Në tryezën e rrumbullakët u prezantuan gjetjet e *Vlerësimit të STA-së* tusit aktual juridik të MIA-it në aspektin e autonomisë institucionale dhe pavarësisë editoriale, si dhe *Analiza Krahasuese* e mënyrës së rregullimit ligjor të agjencive informative të lajmeve në disa vende të rajonit.

Në bazë të gjetjeve të vlerësimit, intervistave të realizuara dhe diskutimit që u zhvillua në tryezën e rrumbullakët të mbajtur në Veles, dolën këto përfundime:

---

<sup>9</sup> Në debatin e moderuar prej ekspertëve të mediave ndërkombëtarë dhe të vendit u prezentuan këto institucione, shoqata dhe organizata: Agjencia Informative Mediatike (AIM), Kuvendi I Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punëtorëve të Mediave.

- Nuk ka dyshim se rregullimi ligjor ekzistues i MIA-it nuk siguron autonominë e saj institucionale në kryerjen e veprimtarisë për të cilën është themeluar. Fakti që MIA-i është i organizuar sipas modelit të shoqërisë aksionare në pronësi të plotë shtetërore, e vendos atë në pozitë të varësisë së plotë nga vendimet e Qeverisë, e cila në përputhje me Ligjin për Shoqëri Tregtare i ushtron të drejtat dhe obligimet e Kuvendit të SHA MIA. Përkatësisht, në përputhje me nenin 383 paragrafit 1 të Ligjit për Shoqëri Tregtare, Qeveria vendos për miratimin e dokumenteve vendimtare që rregullojnë strukturën e saj organizative dhe punën, për zgjedhjen e organeve drejtuese, për statusin dhe shpërblimin e punonjësve dhe për çështje të tjera të rëndësishme për funksionimin e MIA-it. Në vendet e tjera, modelet dhe përvojat ligjore të të cilave u prezantuan, funksionimi i agjencisë së lajmeve të informacionit që kryen veprimtari me interes publik, rregullohet me ligj të veçantë, i cili siguron gjithashtu pavarësi të plotë në ushtrimin e veprimtarisë prej Qeverisë dhe çdo organi tjetër shtetëror.
- MIA nuk ka as pavarësi financiare, sepse çështja e financimit të saj nuk është rregulluar fare. Vendimi i Qeverisë i vitit 2006 nuk përmban asnjë dispozitë me të cilat përcakohet finansimi i pavarur, i qëndrueshëm dhe afatgjatë i MIA-it. MIA financohet kryesisht nga Buxheti i RMV-së, nga mjetet e planifikuara për Shërbimin për Çështje të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë, zëri Subvencione për Ndërmarrjet Publike. Në praktikë, kjo do të thotë se vendimi për shumën e mjeteve që MIA do të marrë çdo vit varet nga e drejta diskrete e Qeverisë. Përvojat krahasuese nga vendet e tjera të rajonit tregojnë se agjencitë financohen kryesisht nga buxheti, me mundësinë e përfitimit të të

ardhurave shtesë nga shitja e produkteve dhe shërbimeve, por kjo është e rregulluar qartë në aktin ligjor, duke garantuar finansim të qëndrueshëm, të pavarur dhe të parashikueshëm në afat më të gjatë. Modelet e mundshme të financimit janë: përcaktimi i një përqindjeje të caktuar të fondeve në buxhet ose lidhja e një kontrate (shumëvjeçare) ndërmjet agjencisë dhe qeverisë bazuar në një vlerësim të mirëfilltë të fondeve të nevojshme buxhetore për ofrimin e shërbimit publik që e ushtron agjencia.

- Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të organeve drejtuese të MIA-it nuk është e pavarur dhe transparente. As Vendimi i Qeverisë dhe as Statuti i MIA-it nuk përmbajnë dispozita që kërkojnë procedurë të pavarur dhe transparente të zgjedhjes të organeve drejtuese të MIA-it, nuk e rregullon çështjen e konfliktit të interesave dhe nuk përmban kritere për zgjedhjen e personave të pavarur dhe ekspertëve në organet drejtuese të MIA-it. Nuk janë rregulluar as procedura dhe kriteret për zgjedhjen e drejtorit të MIA-it. Ligjet që rregullojnë funksionimin e organeve të ngjashme në vendet fqinje përmbajnë dispozita të hollësishme: që organet drejtuese dhe menaxhuese për udhëheqjen e agjencisë zgjidhen në bazë të një konkursi publik, mbi kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët, për çështjen e konfliktit të interesit, si dhe për kushtet në të cilat anëtarët e këtyre organeve mund të shkarkohen.
- Statusi i gazetarëve dhe punonjësve tjerë në MIA nuk është i rregulluar qartë. Këtë përfundim ka edhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, i cili duke vepruar sipas një parashtrese për korrupsion të dorëzuar nga një person i panjohur, ka marrë Vendim që të Qeveria e RMV-së, të paraqesë

nismë për rregullimin e statusit juridik të MIA-it me ligji të posaçëm, me qëllim tejkalimin e zbrazëtirave të identifikuara ligjore në lidhje me statusin e punonjësve dhe kompetencat e organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse të saj. Në vendet e tjera të rajonit, statusi i gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të agjencive informative të lajmeve rregullohet me ligj të veçantë, duke theksuar se agjencia rregullon dhe vendos në mënyrë të pavarur çështjet e punësimit të punëtorëve dhe të drejtat dhe detyrat e tyre.

- Aktet ligjore ekzistuese nuk rregullojnë obligimet e punës të MIA-it në raport me publikun dhe transparencën dhe rregullat që dalin nga Ligji për ndihmën shtetërore në rastet kur personi juridik që financohet nga Buxheti kryen edhe veprimtari komerciale.

## **II ANALIZA KRAHASUESE** e rregullimit të STA-së tusit ligjor të agjencive të lajmeve

### **Sandra Bashiq Hrvatin**

Analiza krahasuese bazohet në një pasqyrë të STA-së tusit ligjor të agjencive të lajmeve në vende të ndryshme evropiane si dhe në përzgjedhjen e modeleve konkrete që do të përdoren për rregullimin e statusit të MIA-it. Disa nga agjencitë e lajmeve janë krijuar me ligj duke i urdhëruar ato të ofrojnë një shërbim publik në fushën e informimit, ndërsa të tjera janë krijuar si një konsorcium që bashkon shumë organizata mediatike në një vend të caktuar. Disa janë agjenci shtetërore (në kuptimin e ofrimit të një burimi jetik të informacionit brenda zinxhirit të informacionit për qytetarët, si dhe për vetë median), dhe të tjera janë agjenci të tjera, ndërmarrje komerciale që shesin shërbimet e tyre në tregun e lirë.

Nuk ka një "model universal" të menaxhimit legjislativ, organizativ dhe financiar të një agjencie mediatike/shtypi në nivel evropian që mund të zbatohet për të rregulluar statusin e MIA-it. **APA (APA - Austria Presse Agentur)**<sup>10</sup> është në pronësi të gazetave austriake dhe servisit publik kombëtar ORF. DPA Gjermane (**DPA – Deutsche Presse-Agentur**)<sup>11</sup> është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (GmbH). Klientëve të DPA-së u ofrohen shërbime për një tarifë mujore të sheshtë (vlerësuar sipas madhësisë së

---

<sup>10</sup> Please see: <https://apa.at>

<sup>11</sup> Please see: <https://www.dpa.com/de>

medias)<sup>12</sup>. ANSA italiane (**Agencia ANSA IT The Agencia Nazionale Stampa Associata**)<sup>13</sup> është një kooperativë jofitimprurëse, anëtarët dhe pronarët e së cilës janë 36 organizata kryesore të lajmeve në Itali. Misioni i tyre është të shpërndajnë raportime të drejta dhe objektive të lajmeve. AFP Franceze (**AFP - Agence France Presse**)<sup>14</sup> është një kompani private me një status të veçantë. Statuti i AFP-së u ndryshua në vitin 2015 për t'u harmonizuar me legjislacionin e BE-së përmes ligjit nr. 2015-433 të 17 Prillit të vitit 2015. Financimi i AFP-së nga shteti u ndryshua dhe u strukturua në dy komponentë: kompensim financiar për misionet me interes të përgjithshëm të Agjencisë dhe abonime tregtare nga shteti. Rojters (**Reuters**)<sup>15</sup> është një lider global në prodhimin dhe shpërndarjen e lajmeve multimediale. Reuters është një biznes i pavarur në pronësi të Korporatës Thomson Reuters.

Duket qartë se ekzistojnë gjashtë modele qeverisje/rregullimi të paraqitura nga gjashtë agjencitë (media) më të mëdha evropiane të shtypit, të cilat janë kryesisht rezultat i drejtpërdrejtë i politikave të ndërgjegjshme kombëtare të medias. Është e pamundur të përsëritet dhe zbatohet ndonjë prej këtyre modeleve në mjedisin mediatik të Maqedonisë së Veriut.

Vendimi për të zgjedhur dy forma specifike rregullimi (duke përdorur shembujt e **Agjencisë Sllovene të Shtypit - STA**<sup>16</sup> dhe **Agjencisë Kroate të Raportimit të Lajmeve - Hina**)<sup>17</sup> është i rrënjosur në faktin se këto vende janë anëtarë të BE-së dhe

---

<sup>12</sup> Please see: <https://www.dpa.com/de/ueber-die-dpa>

<sup>13</sup> Please see: <https://www.ansa.it>

<sup>14</sup> Please see: <https://www.afp.com/fr/plateforme-de-linfo>

<sup>15</sup> Please see: <https://www.reuters.com>

<sup>16</sup> Please see: <https://english.sta.si/>

<sup>17</sup> Please see: <https://www.hina.hr/english>



rrjedhimisht në rendet e tyre ligjore të brendshme përkatëse i kanë përfshirë dokumentet kryesore që rregullojnë statusin ligjor të medias dhe shërbimeve mediatike. Për krahasim, shtojmë shembullin e **Agjencisë Bullgare të Lajmeve - BTA**<sup>18</sup> sepse dekurajojmë shumë zbatimin e këtij modeli të njëanshëm (agjencia drejtohet nga një drejtor i përgjithshëm pa kurrfarë kontrolli publik) si model i drejtimit që duhet të zbatohet në Maqedoninë e Veriut.

Duke i shtuar kësaj sfondin e përbashkët (të ngjashëm) në rendin juridik, që është një kornizë përkatëse krahasuese për ligjvënësit në Maqedoninë e Veriut. Të gjitha këto vende ndajnë legjislacion të ngjashëm për median, madhësinë e tregut mediatik, strukturën e audiencës dhe sjelljen e përdoruesve dhe për këtë arsye kanë veçori të përbashkëta në sfidat dhe çështjet me të cilat përballen.

Ekziston një përhapje e zakonshme e instrumentalizimit politik të medias nga qeveria në të tre vendet; për shembull, në periudhën midis 2021 dhe 2022, STA iu nënshtrua një presioni të konsiderueshëm politik, i cili çoi në pezullimin e financimit ligjërësht të detyrueshëm shtetëror, duke e detyruar kështu STA-në të zgjidhte situatën e saj të pasigurt duke kërkuar mbështetje financiare edhe nga publiku, si dhe nga shoqatat profesionale të gazetarëve.

Për më tepër, faktorë që kontribuojnë në instrumentalizimin politik të medias janë mjedisi i paqëndrueshëm financiar (një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave të medias vjen nga reklamat shtetërore ose kompanitë reklamuese të zotëruara pjesërisht ose plotësisht nga shteti); përpjekje të vazhdueshme për të kufizuar

---

<sup>18</sup> Please see: <https://www.bta.bg/en>

autonominë e medias dhe gazetarëve; dhe fuqia relativisht e ulët në treg e gjithë sektorit të medias.

Meqenëse synimi i kësaj analize është të diskutojë shembuj konkretë të rregullimit të agjencive të shtypit brenda tre vendeve të përzgjedhura, është thelbësore të drejtohet fokusi drejt mënyrave specifike që mundësojnë mekanizmat efektivë, të përcaktuar nga legjislacioni i veçantë, për tu siguruar pavarësia e MIA-it, legjislacioni duhet të përfshijë këto elemente:

- Dispozita të përgjithshme që i referohen përcaktimit të saktë të koncepteve të shërbimit publik dhe sigurimit të punës së paanshme dhe të besueshme gazetareske të rrënjosur në standardet e gazetarisë profesionale;
- Specifikimi i llojeve të të drejtave të pronësisë dhe menaxhimit (qoftë shoqëri me shumicë shtetërore apo ndërmarrje publike);
- Përcaktimi i premisave bazë të transparencës së punës (nga jashtë) dhe sigurimi i autonomisë editoriale dhe gazetareske (interne);
- Kapitull i veçantë i ligjit që synon përcaktimin e strukturës së brendshme organizative të agjencisë, konkretisht zgjedhjen e organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse;
- Përcaktimi i vëllimit të shërbimeve publike për të cilat merren fonde publike dhe bërja e dallimit ndërmjet aktiviteteve publike dhe tregtare të agjencisë. Shuma e financimit publik llogaritet në bazë të vlerësimit të funksioneve në fushën e shërbimeve publike që i janë dhënë agjencisë me ligj;
- Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së të drejtave të punonjësve, veçanërisht gazetarëve.

Analiza zhvillohet duke filluar me prezantimin e mekanizmave vendimtarë që sigurojnë pavarësinë e agjencive të lajmeve, pasuar nga prezantimi i zgjidhjeve konkrete që rrjedhin nga legjislacioni në tre vendet e përzgjedhura. Sigurimi i pavarësisë së medias dhe gazetarëve është i një rëndësie jetike për të mbrojtur të drejtën themelore të njeriut për lirinë e shprehjes, e cila është një e drejtë kushtetuese në të tre vendet.

Pavarësia e agjencisë së lajmeve (medias) duhet të mbrohet në tre nivele: institucionale, organizative dhe financiare.

**Pavarësia institucionale** zakonisht sigurohet nga legjislacioni specifik i cili përcakton të drejtat dhe detyrimet e agjencisë. Është thelbësore të sigurohet pavarësia e punës së agjencisë nga ndikimi politik dhe ekonomik (përcaktimi i kuptimit të shërbimit publik dhe dobisë publike në fushën e medias) dhe të përcaktohet rrjeti i masave mbrojtëse institucionale për menaxhimin, drejtimin dhe mbikëqyrjen e punës së agjencisë. Këto masa mbrojtëse duhet të përfshijnë kushte të përcaktuara në mënyrë specifike për emërimin dhe shkarkimin e organeve drejtuese, administrative dhe mbikëqyrëse (ndalimi i konfliktit të interesit, praktikat klienteliste dhe korrupsioni sistemor) dhe një garanci e qartë nga themeluesi (parlamenti ose qeveria) për autonominë institucionale të agjencisë. Kjo i referohet një angazhimi, të përcaktuar nga legjislacioni, për të garantuar ndalimin e çdo lloji ndikimi mbi drejtimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e agjencisë, veçanërisht një refuzim të plotë të ndikimit mbi pavarësinë editoriale.

**Pavarësia organizative** sigurohet me dispozita konkrete brenda legjislacionit me të cilat ruhet autonomia e gazetarit dhe politika redaktuese, mbrojtjen e standardeve

profesionale të profesionit të gazetarit dhe ndikimin e gazetarëve mbi vendimet kryesore të redaktorëve të emëruar.

**Pavarësia financiare** sigurohet nga ndarja e parashikuar, e mjaftueshëm dhe transparente e fondeve për vendosjen e shërbimit publik, që nuk duhet të lidhet me ciklet politike brenda shoqërisë dhe duhet të sigurojë diversitetin në burimet e financimit (duke bërë dallimin e qartë midis përdorimit të burimeve publike dhe komerciale), duke lehtësuar përgjegjshmërinë financiare dhe transparencën.

Në pjesën tjetër do të përqendrohemi në një analizë krahasuese të legjislacionit për statusin ligjor të Agjencisë Sllovene të Shtypit (Slovenska tiskovna agencija, në vazhdim: STA) dhe të Agjencisë Kroate të Raportimit të Lajmeve (Hrvatska izvještajno novinarska agencija, në vazhdim: Hina) pas përmendjes më pare të tre boshteve të analizës. Analiza i referohet Aktit për Agjencinë Sllovene të Shtypit (në vazhdim: Ligji për STA; Zakon o STA)<sup>19</sup> dhe Ligjit për Agjencinë Kroate të Raportimit të Lajmeve (në vazhdim: Ligji për Hina; Zakon o Hina)<sup>20</sup>. Po përmendim rastin konkret të rregullores legjislative të Agjencisë Telegrafike Bullgare (Blgarska telegrafna agencija, në vazhdim BTA) siç përcaktohet me Ligjin për BTA (në vazhdim, Ligji për BTA-në; Zakon za Blgarskata telegrafna agencija)<sup>21</sup>. Disa nga zgjidhjet shoqërohen me nene konkrete të legjislacionit përkatës.

---

<sup>19</sup> Ligji i Agjencisë Sllovene të Shtypit (**Law on Slovenian Press Agency**), I disponueshëm në:

<http://www.pisrs.si/Pis.web/pregledPredpisa?id=ZAKO5868https>, Agency's website: [www.sta.si](http://www.sta.si).

<sup>20</sup> Ligji i Agjencisë Kroate të Raportimit të Lajmeve (**Law on Croatian News Agency**) I disponueshëm në:

<https://www.zakon.hr/z/1263/Zakon-o-Hrvatskoj-izvještajnoj-novinskoj-agenciji>, Agency's website: [www.hina.hr](http://www.hina.hr).

<sup>21</sup> Ligji për Agjencinë Telegrafike Bullgare (**BTA Act**), I disponueshëm në: [Lex.bg](http://lex.bg) - [Закони, правилници,](http://lex.bg)

[конституция, кодекси, държавен вестник, правилници по прилагане](http://lex.bg), Agency's website: [www.bta.bg](http://www.bta.bg)

## **1. Pavarësia institucionale**

Të dy vendet (Sllovenia dhe Kroacia) kanë krijuar agjencitë e tyre të lajmeve me ligj (Akt). Duhet të theksohet se STA është e organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themelues dhe bashkëpunëtor i vetëm i së cilës është Republika e Sllovenisë. Të drejtat asociative ushtrohen nga qeveria në emër të Republikës së Sllovenisë. Për dallim nga STA-ja, Hina është person juridik, statusi ligjor i të cilit është

ai i një ndërmarrjeje publike. Themeluesi i saj është Republika e Kroacisë. Themeluesi merr pjesë qind për qind në sigurimin e burimeve të nevojshme për funksionimin e Hina. Ligji për STA-në (neni 3) thotë qartë se detyrimet e themeluesit përfshijnë sigurimin e autonomisë institucionale dhe pavarësinë editoriale të STA-së , si dhe financimin e duhur të veprimtarisë së shëndetshme dhe të papenguar të shërbimit publik, bazuar në planin vjetor të biznesit të STA-së -së.

Ligji për BTA-në e definon agjencinë si një institucion të pavarur kombëtar për lajme që financohet tërësisht nga buxheti i shtetit (neni 1, paragrafi 2). BTA vepron në interesin më të mirë të publikut dhe shtetit dhe është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Bullgarisë dhe Ligjit të Agjencisë Telegrafike Bullgare, gëzon të drejtën e diskrecionit në përcaktimin e përmbajtjes së punës së saj për grumbullimin e lajmeve dhe shpërndarjen e lajmeve dhe merr përgjegjësinë për këtë operacion. BTA-ja është e pavarur në ushtrimin e funksionimit të saj dhe i përgjigjet Kuvendit Kombëtar.

Të dy modelet ekonomike (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe ndërmarrje publike) kanë të mirat dhe të këqijat e tyre. Përparësia e një shoqërie me përgjigjeësi të kufizuar është fleksibiliteti dhe pavarësia më e madhe e drejtimit të përgjithshëm kur bëhet fjalë për përcaktimin e politikave të përsëritura të agjencisë (p.sh. politika kadrovike), ndërsa ndërmarrja publike vë më shumë theks për të punuar në drejtim të interesit publik për të gjithë konsumatorët nën të njëjtat kushte. Zgjedhja e modelit ekonomik është çështje marrëveshjeje në nivel të politikës kombëtare. Çështja thelbësore është që legjislacioni të sigurojë një ndarje të qartë midis institucioneve shtetërore dhe autonomisë editoriale. Menaxhmenti i përgjithshëm (organet

mbikëqyrëse ose drejtuese) nuk duhet të lejohet të ndikojë në politikat editoriale, të cilat janë ekskluzivisht nën domenin e kolektivit të gazetarëve. Kjo nuk është e garantuar në rastin e BTA-së.

Ligji për Hina-n në nenin 5 përcakton se agjencia funksionon sipas parimeve të raportimit të pavarur, të paanshëm dhe profesional të agjencisë së lajmeve. Hina nuk duhet të jetë nën asnjë lloj ndikimi që do të rrezikonte saktësinë, paanshmërinë dhe besueshmërinë e informacionit të saj. Hina nuk duhet të jetë ligjërisht ose faktikisht nën pronësinë ose kontrollin tjetër të një grupi të interesit ideologjik, politik ose ekonomik. Një dispozitë e ngjashme ekziston edhe në Ligjin për STA-në (neni 7), ku thuhet se STA-ja nuk mund të marrë parasysh në asnjë rrethanë ndikime dhe pikëpamje që mund të ndikojnë në saktësinë, paanshmërinë dhe besueshmërinë e informacionit. STA nuk guxon, ligjërisht apo realisht të varet nga asnjë grup ideologjik, politik apo ekonomik.

Neni 4 i Ligjit për STA-në përcakton kryerjen e shërbimit publik si krijimin, përgatitjen, arkivimin dhe transmetimin e përditshëm të lajmeve që përmbajnë informacione thelbësore për ngjarjet dhe për atë çfarë ndodh në Republikën e Sllovenisë në gjuhën sllovene, duke mbuluar fushat e mëposhtme me interes si: politika, ekonomia, kultura, arsimi, shëndetësia, kronika, sporti, ngjarjet botërore, shkenca, organizatat vullnetare dhe joqeveritare, argëtimi dhe përmbajtje të tjera. Të njëjtat kushte vlejnë edhe për shërbimin publik në gjuhën angleze. Korniza e shërbimit publik të STA-së përfshin gjithashtu edhe publikimin e teksteve të lajmeve radiofonike (të përgatitura për t'u transmetuar në radio) si dhe fotografimin e ngjarjeve kryesore, më të drejta të mbrojtura të autorit. Për më tepër, ai kërkon sigurimin e përmbajtjes për

aktivitetet e pakicave italiane dhe hungareze të njohura zyrtarisht, përmbajtje për aktivitetet e komunitetit etnik rom, përmbajtje për pakicat e tjera kombëtare dhe etnike në Republikën e Sllovenisë, përmbajtje për pakicat sllovene në vende të tjera, përmbajtje për mërgimtarët sllovenë anëmbanë globit dhe së fundi, si pjesë e shërbimit publik të përditshëm në gjuhën angleze, përmbajtje për publikun e huaj në Republikën e Sllovenisë. Përmbajtja në kuadër të shërbimit publik transmetohet falas përmes faqes së saj të internetit ([www.sta.si](http://www.sta.si)) dhe është e aritshme për të gjithë në të njëjtat kushte.

Ligji për Hinën, neni 3, është më i kursyer me fjalë kur flet për përcaktimin e aktiviteve të Hinës, duke i kufizuar ato në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit të plotë faktik dhe objektiv të agjencisë së lajmeve për ngjarjet në Republikën e Kroacisë dhe në botë për nevojat e mediave dhe të pjesëmarrësve të tjerë të jetës shoqërore, politike, kulturore dhe ekonomike.

Pavarësia organizative sigurohet në dy nivele: në nivelin e pavarësisë së brendshme menaxheriale dhe në nivelin e pavarësisë së brendshme editoriale dhe gazetareske. Një faktor i rëndësishëm kontribues për sigurimin e pavarësisë së organizatës është rregullimi i formës së menaxhimit, mbikëqyrjes dhe administrimit të agjencisë. Të dyja agjencitë kanë një formë menaxhimi të dyanshëm: STA-ja ka një Këshill Mbikëqyrës dhe një Menaxher të Përgjithshëm dhe Hina ka një Këshill Drejtues dhe një Drejtor (Menaxheri i Përgjithshëm).

Mendimi ynë është se Ligji për BTA-në nuk siguron pavarësi menaxheriale pasi që i gjithë drejtimi i BTA-së është i ndërthurur me qeverinë, përveç disa angazhimeve deklarative ndaj parimeve të supozuara (shih nenin 4) që supozohet se BTA -jai



ndjekë. BTA-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga një Drejtor i Përgjithshëm që emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga parlamenti (neni 10). I rëndësishëm është gjesti simbolik i betimit të drejtorit të përgjithshëm në parlament para deputetëve. Teksti i betimit është përfshirë në ligj, neni 12 (paragrafi 2).

	STA	HINA
Mbikqyrja	Këshilli mbikqyrës përbëhet prej pesë anëtarëve. Kuvendi popullor emëron katër anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës me propozim të Qeverisë: secili anëtar zgjidhet nga lëmi të ndryshme të ekspertizës (media, ekonomi-financa, drejtësi, informatikë). Njërën prej anëtarëve të Këshillit Drejtues e zgjedh Këshilli i Punëtorëve në bazë të legjislacionit që rregullon pjesëmarrjen e punëtorëve (nëpunësve) në drejtimin e agjencisë. Kuvendi Popullor pastaj i emëron anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës pas	Këshilli Drejtues përbëhet prej kryetarit, nënkryetarit dhe tre anëtarëve. Ata i emëron dhe shkarkon parlamenti kroat. Njëri prej anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjidhet prej punëtorëve të Hinës, tjetri është ekspert nga lëmi i mediave, ndërsa tre anëtarët e tjerë janë ekspertë nga lëmi i ekonomisë, financave, drejtësisë dhe informatikës. Qeveria e Republikës së Kroacisë nis procesin e përzgjedhjes për Këshillin Drejtues përmes shpalljes publike. Qeveria ia propozon anëtarët e Këshillit parlamentit, i cili debaton për secilin prej anëtarëve të propozuar veçmas

	<p>procesit zgjedhor (zgjedhje me shumicë votash nga të gjithë anëtarët e parlamentit); për secilin kandidat votohet veçmas.</p>	<p>dhe vendimi i tyre miratohet mbi bazën e pëlqimit paraprak të komisionit përkatës të parlamentit kroat.</p>
Menaxhimi	<p>Drejtorin e përgjithshëm e emëron Këshilli Mbikëqyrës përmes shpalljes publike. Pas emërimit, prej drejtorit të përgjithshëm kërkohet të sigurojë çertifikatë për kompetencë, që vlenë në Republikën e Sllovenisë, për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ose Këshillin e Drejtorëve.</p>	<p>Këshilli Drejtues e emëron menaxherin e përgjithshëm (drejtorin) në bazë të shpalljes publike.</p>

Organizimi i brendshëm i STA-së rregullohet me Ligjin për themelimin e SHPK Agjencia Sllovene e Shtypit, i cili përcakton organet e STA-së dhe juridiksionin e tyre përkatës, kërkesat për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm, kryeredaktorit dhe redaktorëve të tjerë si dhe fushën e tyre të punës dhe marrëdhëniet juridike ndërmjet drejtorit të përgjithshëm, Këshillit Mbikëqyrës dhe Redaksisë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të STA-së kërkohet të kenë të paktën një diplomë universitare të nivelit të dytë ose një lloj tjetër diplome në arsim, të cilën

legjislacioni e njej si ekuivalente, si dhe të paktën dhjetë vjet përvojë pune ose pesë vjet përvojë menaxheriale nga lëmi të ndryshme për të siguruar njohuritë dhe ekspertizën e duhur të nevojshme për mbikëqyrjen e STA-së. Ligji për STA-në përcakton në mënyrë të plotë konfliktin e interesit në nenin 12, i cili parandalon çdo lloj interesi personal, ekonomik apo politik që të ketë ndikim mbi Këshillin Mbikëqyrës. Përgjegjësitë kryesore të Këshillit Mbikëqyrës janë: miratimi i planit vjetor të biznesit me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, miratimi i raportit vjetor të biznesit të shoqërisë; ndarja e tepricës së të ardhurave (me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm) dhe përzgjedhjen dhe emrimin e Drejtorit të Përgjithshëm të STA-së në bazë të një shpalljeje të hapur. Drejtori i Përgjithshëm ka autoritet të pakufizuar përfaqësimi me përjashtim të rasteve të lidhjes së kontratave kreditore dhe investime që kalojnë masën 5 për qind të të ardhurave vjetore bruto të STA-së (nga viti paraardhës), kur kërkohet miratimi i Këshillit Mbikëqyrës. Drejtori i Përgjithshëm i STA-së zhvillon dialog social me përfaqësuesit e sindikatave gjegjëse të STA-së , si dhe lidh marrëveshjen kolektive të punës të STA-së dhe vepron si përfaqësues i STA-së (si pjesë e punëdhënësve) kur nënshkruan marrëveshjen kolektive të punës për gazetarë profesionistë.

Ligji për Hina ofron një përkufizim mjaft të përgjithshëm të konfliktit të interesit. Neni 11 thotë se anëtari i Këshillit Drejtues nuk mund të jetë një nëpunës shtetëror, një person që mban një pozicion drejtues në organet e një partie politike ose një person që është i punësuar ose kryen ndonjë punë tjetër në kompani konkurrenente që mund të çojë në konflikt interesi. Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues përfshin, ndër të tjera, miratimin e planit të zhvillimit dhe programit të punës, miratimin e konstruksionit financiar, raportin vjetor financiar si dhe emërimin dhe shkarkimin e drejtorit.

## **2. Pavarësia e brendshme organizative**

Autonomia editoriale dhe gazetareske rregullohet nga nenet brenda legjislacionit që përcaktojnë emërimin dhe shkarkimin e redaktorëve dhe ndikimin e redaksisë (punonjësve) ndaj këtij procesi. Kryeredaktori i STA-s emërohet dhe shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm pas marrjes së mendimit paraprak nga redaksia. Kryeredaktori përzgjidhet me shpallje të hapur. Drejtori i Përgjithshëm duhet të konsultohet me redaksinë për kandidatët e mundshëm përpara se të emërojë kryeredaktorin. Nëse nuk ka miratim të shumicës në redaksi, emërimi i kandidatit në fjalë kalohet në Këshillin Mbikëqyrës. Në raste të tilla, redaksia ka të drejtë të ofrojë propozimin e saj prej kandidatëve të paraqitur në shpalljen e hapur për funksionin e

kryeredaktorit. Redaktorët e rubrikave të veçanta emërohen dhe shkarkohen nga kryeredaktori në bazë të mendimit paraprak të kolegjiut të redaksisë. Mandati i tyre është i lidhur me mandatin e kryeredaktorit.

Kryeredaktori i Hina emërohet nga Këshilli Drejtues pas thirrjes publike dhe propozimit të drejtorit të Hina, bazuar në miratimin paraprak të gazetarëve. Në rast se gazetarët nuk miratojnë emërimin e kryeredaktorit, drejtori mund të propozojë një kandidat tjetër.

### **3. Pavarësia financiare**

BTA-ja financohet tërësisht nga buxheti i shtetit, shërbimet e saj ofrohen falas për konsumatorët (shih Kapitullin 4 të Ligjit për BTA).

STA-ja financohet nga: buxheti i shtetit drejtpërdrejt bazuar në një kontratë vjetore ndërmjet themeluesit dhe STA-së; aktivitetet e marketingut; sponsorizimi dhe donacionet dhe burime të tjera në përputhje me ligjin dhe aktin për themelimin e STA-së. Shuma e kompensimit të marrë çdo vit nga STA-ja nëpërmjet kontratës së shërbimit publik nuk mund të kalojë shumën e përgjithshme të shpenzimeve të përcaktuara nga plani vjetor i biznesit të STA-së . Në rast se kompensimi tejkalon vlerësimin vjetor më shumë se dhjetë për qind, teprica mbi dhjetë për qind duhet të kthehet direkt në buxhetin e shtetit. Buxheti i shtetit financon vetëm aktivitete në fushën e shërbimit publik. STA-ja mund të kryejë aktivitete që nuk përfshihen në kuadrin e shërbimit publik, duke përfshirë: marketingun e përmbajtjes së gjerë mediatike, veçanërisht lajmet përmbledhëse, tekstet tematike ose analitike të gazetarëve, biografite, intervistat, kronologjitë; marketingun e hapësirës reklamuese të seksionit të platformës jashtë sferës së shërbimit publik: lehtësimin për krijimin e shërbimeve të specializuara; shërbimet e marketingut, duke përfshirë përmbajtjen dhe shërbimet interaktive të tregtueshme; organizimin e ngjarjeve publike; lehtësimi ofrimit të mesazheve tekstuale origjinale të STA-së ; aktivitete botuese të destinuara vetëm për qëllime komerciale; përdorimin komercial të lëndës arkivore dhe aktivitete të tjera në përputhje me ligjin (Ligji për STA, neni 5). Legjislacioni kërkon transparencë financiare për shërbimin publik (neni 6) që do të thotë se STA-ja siguron një ndarje të përcaktuar, transparente dhe të përshtatshme të aktiviteteve ndërmjet aktiviteteve të shërbimit publik dhe marketingut, duke përfshirë një ndarje të veçantë në mbajtjen e kontabilitetit. Kontabiliteti i brendshëm duhet të ndajë shërbimin publik dhe aktivitetet e orientuara drejt fitimit. STA ndjek parimet e gazetarisë dhe agjencisë informative të rrënjësura në transparencë, paanshmëri dhe

profesionalizëm. STA gjithashtu i përmbahet parimit të pavarësisë organizative dhe financiare (neni 8). Puna e përgjithshme dhe funksionimi i biznesit të STA-së i nënshtrohet një revizioni të detyrueshëm vjetor të kryer nga një revizor i autorizuar ose shoqëri revizore, e cila nga ana tjetër përcakton përshtatshmërinë dhe rregullsinë e punës afariste (neni 21). STA-ja ofron një raport vjetor biznesi dhe raport revizioni mbi efikasitetin dhe rregullsinë e operacioneve nga paragrafi i parë i nenit të mëparshëm për ta njoftuar Asamblenë Kombëtare. Këshilli Mbikëqyrës i paraqet Asamblesë Kombëtare një raport vjetor të punës së tij.

Ligji për Hinën përcakton se agjencia gjeneron të ardhura përmes: kontratës me themeluesin, kontratës me shfrytëzuesit e shërbimeve dhe donacioneve e aktiviteteve të tjera që janë pjesë e funksionimit të saj. Për të siguruar një ekuilibër real midis të ardhurave dhe shpenzimeve të përcaktuara nga *programi* i punës dhe konstrukti financiar, Hina koordinon çdo vit çmimet e shërbimeve të saj me përfaqësuesit e themeluesit dhe përdoruesit.<sup>22</sup> Pavarësisht burimeve të ndryshme të financimit (publike dhe tregtare), legjislacioni nuk përcakton një kërkesë të qartë për kontabilitet të veçantë dhe një ndalim të rrjedhjes së fondeve. Hina është përgjegjëse për të gjitha detyrimet e saj financiare me asetet e veta. Themeluesi, megjithatë, ka një përgjegjësi të përbashkët të pakufizuar për humbjet financiare. Borxhet shlyhen kryesisht nga pasuria e Hinës dhe vetëm më pas nga buxheti i shtetit (neni 28 i Ligjit për Hinën). Agjencia nuk mund të shpallë falimentimin pa miratimin e parlamentit kroat. Nëse qeveria nuk shlyen borxhet brenda 90 ditëve ose vendos

---

<sup>22</sup> Konstruktet vjetore financiare dhe raportet financiare të Hinës janë të disponueshme në:  
[https://www.hina.hr/info/fin\\_plan](https://www.hina.hr/info/fin_plan).

për një mënyrë tjetër për të mbuluar humbjen financiare, është e mundur të shpallet falimentimi.

### **III REKOMANDIME**

Në tryezën e rrumbullakët “Zgjidhjet për pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e Agjencisë informative mediatike (MIA)”, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve përkatëse shtetërore, shoqatat e gazetarëve, organet e pavarura rregullatore dhe ekspertë të medias, u miratuan njëzëri rekomandimet e mëposhtme:

#### **Rekomandimi 1 - Procedura për miratimin e ligjit të veçantë për MIA**

Organizimi, financimi dhe mënyra e funksionimit të MIA-it duhet të rregullohet me ligj të veçantë që do të përcaktojë të drejtat dhe obligimet e Agjencisë informative



Mediatike (MIA) në fushën e informimit publik si person juridik që kryen veprimtari me interes publik.

I rekomandohet Qeverisë që të nisë procedurë për hartimin e një ligji të tillë, ku hapi i parë do të ishte formimi i një grupi punues të përbërë prej palëve të interesuara, i cili do të merrte në konsideratë të gjitha aspektet e rëndësishme që duhet të përmbajë ligji dhe do të propozonte një zgjidhje të përshtatshme ligjore në përputhje me dispozitat pozitive të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat do të siguronin autonomi të plotë institucionale dhe financiare dhe pavarësi editoriale të MIA-it.

### **Rekomandimi 2 – Garantimi i pavarësisë editoriale të MIA-it**

Ligji që do të rregullonte punën e MIA-it duhet të përmbajë dispozita të veçanta me të cilat do të garantohet pavarësia e saj redaktuese; më konkretisht, do të përcaktohet se MIA punon sipas parimeve të raportimit të pavarur, të paanshëm dhe profesional të agjencive të lajmeve dhe se MIA nuk guxon të nënshtrohet ndaj asnjë trysnie të jashtme që synon të ndikojë në saktësinë, objektivitetin dhe besueshmërinë e informacionit që publikon. Është gjithashtu e rëndësishme që në ligj të përfshihen dispozita që do të sigurojnë pavarësinë e gazetarëve që punojnë në MIA dhe të drejtën për të refuzuar zbatimin e një urdhri që është në kundërshtim me normat profesionale dhe etike të profesionit të gazetarit. Gazetarëve të punësuar në MIA duhet t'u jepet e drejta për të dhënë mendim kur vendoset për zgjedhjen e kryeredaktorit të MIA-it.

### **Rekomandimi 3 – Sigurimi i autonomisë së plotë institucionale**

Gjatë hartimit të ligjit, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet gjetjes së formës së duhur ligjore të organizimit të MIA-it. Sipas përvojave krahasuese të vendeve të tjera, funksionimi i agjencive informative të lajmeve që kryejnë veprimtari me interes publik rregullohet me ligj të veçantë, i cili siguron pavarësi të plotë në kryerjen e veprimtarisë nga qeveria apo çdo organ tjetër shtetëror.

Për të arritur realizimin efektiv dhe të plotë të autonomisë institucionale dhe financiare të MIA-it, krahas dispozitave të ligjit të posaçëm, nevojitet edhe harmonizimi i dispozitave tjera ligjore, zbatimi i të cilave ka të bëjë edhe me funksionimin e MIA-it (p.sh. Ligji për media, Ligji për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizive, Ligji për Buxhetin, Ligji për nëpunësit administrativë, etj.)

#### **Rekomandimi 4 - Zgjedhja e organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse**

Ligji që do të rregullonte funksionimin e MIA-it duhet të përmbajë dispozita të hollësishme: për atë që organet drejtuese dhe menaxhuese të agjencisë zgjidhen në bazë të konkursit publik, kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët, çështjen e konfliktit të interesit dhe kushtet nën të cilat anëtarët e këtyre organeve mund të shkarkohen.

#### **Rekomandimi 5 - Modeli i financimit**

Financimi i MIA-it gjithashtu duhet të rregullohet me ligj, të jetë i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm për t'i mundësuar MIA-it në mënyrë afatgjate dhe të pavarur të planifikojë dhe menaxhojë mjetet. Sipas përvojës së mëparshme të financimit të MIA-it, si dhe nga vëzhgimet për financimin e agjencive të ngjashme në vende të tjera, burimet nga të cilat do të financohet MIA, duhet të vazhdojnë të jenë të kombinuara,

që do të thotë se burimi bazë i financimit është Buxheti, ndërsa shërbimet komerciale janë vetëm burime shtesë. Po ashtu, kjo nënkupton se në Ligj duhet të definohet qartë se cilat janë shërbimet e interesit publik që i ofron MIA dhe për të cilat merr mjete nga Buxheti.

Sa i përket modelit të financimit, rekomandohet të merren në konsideratë dy modelet e mundshme: përcaktimi i një përqindjeje fikse të buxhetit të RMV-së ose futja e një dispozite në ligj sipas të cilës Qeveria obligohet të lidhë marrëveshje shumëvjeçare me MIA-in, bazuar në një Program të dorëzuar paraprakisht për sigurimin e shërbimeve publike në fushën e veprimtarisë së raportimit të lajmeve me vlerësim të mjeteve të nevojshme për kryerjen e këtyre shërbimeve publike.

### **Rekomandimi 6 – Kushtet nën të cilat MIA mund të kryejë veprimtari komerciale**

Dispozitat e ligjit të posaçëm me të cilin do të rregullohet puna e MIA-it duhet të përmbajnë edhe dispozita lidhur me mënyrën se si MIA kryen veprimtarinë e saj tregtare.